



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI
KOMISIONI PËR PUNËN, ÇËSHTJET SOCIALE DHE SHËNDETËSINË

Tiranë, më 02.11.2022
Dokument parlamentar
(Komision për dhënie mendimi)

RAPORT
PËR PROJEKTLIGJIN “PËR BUXHETIN E VITIT 2023”
NË PARIM

Drejtuar: Komisionit përgjegjës për Ekonominë dhe Financat

I. Hyrje

Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë, në cilësinë e Komisionit për dhënie mendimi, në mbledhjet e datave 31 tetor dhe 1 nëntor, bëri shqyrtimin në parim të projektligjit “Për buxhetin e vitit 2023”, të paraqitur nga Këshilli i Ministrave.

Në mbledhjen e komisioni morën pjesë Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale znj. Ogerta Manastirliu, Zv. Ministria e Financave dhe Ekonomisë, znj. Olta Manjani, Ministria Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, znj. Bora Muzhaqi, si dhe përfaqësues të tjerë të këtyre ministrive, të cilët bënë paraqitjen e projektbuxhetit për vitin 2023 para anëtarëve të Komisionit dhe iu përgjigjën pyetjeve në parim.

II. Baza kushtetuese e projektligjit, vlerësimi kushtetues dhe procedural

Propozimi i këtij projektligji vjen nga ana e Këshillit të Ministrave, në bazë të nenit 81, pika 1 të Kushtetutës.

Projektligji është bazuar në nenet 78, 83, pika 1, dhe 158 të Kushtetutës. Projektligji për buxhetin i nënshtrohet një procedure të posaçme shqyrtimi, e cila është e parashikuar në Rregulloren e Kuvendit, në nenet 78-85 të saj.

III. Objektivat e Buxhetit 2023

Projektbuxheti 2023 vijon të mbështesë rritjen ekonomike të vendit pavarësisht efekteve negative të 2 fatkeqësive të njëpasnjëshme që goditën Shqipërinë (tërmeti i 26 Nëntorit 2019 dhe pandemia COVID19) si dhe të konfliktit Rusi – Ukrainë në fillimin e vitit 2022.

Njëkohësisht, nëpërmjet politikës së konsolidimit fiskal synohet të sigurohet një ulje e qëndrueshme e stokut të borxhit publik në periudhën afatmesme 2023-2025. Pas recesionit të fortë në vitin 2020, në normën prej -3.5%, ekonomia është rikuperuar fuqishëm në vitin 2021, në normën 8.5% dhe parashikohet të vijojë trendin pozitiv në periudhën afatmesme.

Rritja ekonomike parashikohet në 3.7% për vitin 2023 dhe parashikohet të vijojë të qëndrojë afër nivelit prej 3.7% përgjatë periudhës afatmesme. Për vitin 2023 parashikohet që rritja ekonomike të ngadalësohet në 2.6%, e ndikuar nga zhvillimet dhe pritshmëritë për ekonominë globale dhe veçanërisht atë të Bashkimit Evropian.

Në projektbuxhetin e vitit 2023, programimi i të ardhurave buxhetore mbështet synimet e Qeverisë për rritje ekonomike të qëndrueshme, si dhe uljen e vazhdueshme të defiçitit buxhetor dhe stokut të borxhit publik. Ky programim bazohet në përmirësimin e administrimit fiskal dhe minimizimin e informalitetit në ekonomi, duke mbështetur në këtë mënyrë rritjen ekonomike, si dhe duke nxitur prodhimin dhe eksportet.

Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë e shqyrton këtë projektligj sipas fushës së saj të përgjegjësisë. Konkretisht komisioni do të trajtojë projekt-buxhetin e akorduar për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë për pjesën e Arsimit Profesional dhe marrëdhëniet e punës, si dhe Ministrinë e Shtetit për Rininë dhe Fëmijët.

SHENDETËSIA

- Prioritetet 2023-2025 Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në sektorin e shëndetësisë do të prioritetizojë:

- Financimi i shërbimeve shëndetësore (parësore e spitalore);
- Qëndrueshmëria dhe përmirësimi i situatës financiare institucioneve shëndetësore e të mbrojtjes sociale, nëpërmjet përdorimit me efektivitet të burimeve të financimit, forcimit të kontrollit të shpenzimeve;
- Rritja e kosto-efektivitetit të listës së barnave e pajisjeve të rimbursueshme;
- Financimi i paketave të miratuara të shërbimit spitalor në spitalet publike e jopublike;
- Pagesat për kujdes shëndetësor, sipas marrëveshjeve ndërkombëtare të nënshkruara;
- Intensifikimi i punës për kostimin e shërbimeve të reja shëndetësore, në kujdesin shëndetësor, me synim ndryshimin e mënyrës së financimit të shërbimeve shëndetësore;

-Financimi i shërbimit të kontrollit bazë mjekësor bazë për të paktën 50% të numrit të shtetasve të moshës 35-70 vjeç;

- Rezultatet që synohet të arrihen për periudhën afatmesme 2023-2025:

-Mbulimi universal i popullsisë me shërbim shëndetësor duke parashikuar 6.4 milionë numër vizitash në periudhën 2023-2025, mbështetur në treguesit e sëmundshmërisë.

-Ofrimi i shërbimit të kontrollit bazë (check-up) për mesatarisht 475 mijë pacientë në vit;

-Trajtimi me recetë rimbursimi mesatarisht 400 mijë pacientëve në vit, përgjatë periudhës 2023-2025; --Numri i pacientëve të trajtuar mesatarisht 330 mijë pacientë në vit për periudhën 2023-2025;

-Rritja e numrit të pacientëve që përfitojnë nga paketat e kardiokirurgjisë dhe kardiologjisë mesatarisht 8 600 pacientë përgjatë periudhës 2023-2025;

- Numri i pacientëve përfitues nga shërbimi i dializës për vitin 2023 parashikohet rreth 1,570 pacientë, e çdo vit shtohen mesatarisht rreth 150 pacientë. Mesatarisht çdo pacient kryen 13 seanca në muaj. Për periudhën 2023-2025 parashikohet rritje e ndjeshme e numrit seancave për pacientët që përfitojnë nga trajtimi me dializë nga 245 mijë seanca në vitin 2023, në 270 mijë në vitin 2025;

-Trajtimi i mesatarisht 25 fëmijëve në vit më Sindromën Doën përgjatë periudhës 2023-2025;

-Reduktimit të kohës aktuale prej 13 ditësh të pritjes për ekzaminime të rëndësishme (rezonancë magnetike, skaner etj.);

-Shkalla e mbulimit të popullsisë në moshë punë (kontribues / popullsi në moshë pune) do të jetë mbi 43%.

- Pjesa e kontributeve të sigurimeve shoqërore ndaj totalit të fondeve të alokuara për skemat e sigurimeve shoqërore do të arrijë të mbulojë mesatarisht rreth 64 % të totalit;

- Raporti kontribues/përfitues në periudhën afatmesme ndryshon nga 1.039 për vitin 2022 në 1.015 përgjatë periudhës 2023-2025;

- Depistimi për kancerin e gjirit mesatarisht 5 mijë gra me anë të mamografisë së lëvishme, respektivisht për vitet 2023-2025;

-Depistimi për kancerin e qafës së mitrës mesatarisht 18 mijë gra përgjatë 2023-2025 me synim uljen e vdekshmërisë nga kanceri i qafës së mitrës nga 2.6/100 000 në vitin 2022 në 2.4/100 000 në vitin 2025.

- Rritja e numrit të thirrjeve të adresuara në njësitë e Urgjencës mjekësore nga 550 mijë thirrje në vitin 2022 në 650 mijë thirrje në vitin 2025, me një kohë reagimi mesatarisht prej 16 minutash.

MBROJTJA SOCIALE

- Prioritetet 2023-2025 në fushën e mbrojtjes sociale.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale synon zbatimin me sukses të reformës së programit të përkujdesit social në tre shtyllat kryesore të tij: Ndhima Ekonomike, Aftësia e Kufizuar dhe Shërbimet Sociale.

Më konkretisht synohet:

-Numri i familjeve dhe individëve në nevojë që pritet të përfitojnë nga skema e ndihmës ekonomike parashikohet të jetë mesatarisht 63.5 mijë përfitues në vit përgjatë periudhën 2023-2025;

-Numri i përfituesve nga PAK dhe kujdestarëve të tyre parashikohet të shkojë në 158 mijë në vitin 2025, në kuadër të reformimit të sistemit të vlerësimit të aftësisë së kufizuar;

-Mbështetja e personave nga grupet e pafavorizuara përmes punësimit në ndërmarrjet sociale synohet të punësohen mesatarisht 70 persona çdo vit, me qëllim integrimin në tregun e punës.

-Mbështetjen e fondit social për njësitë e vetqeverisjes vendore për ofrimin e shërbimeve të reja sociale territoriale për grupet në nevojë dhe mbështetjen e familjeve të NE me paketa sociale shëndetësore, me një fond nga 200 milion lekë në 300 milion lekë për vitet 2023-2025.

Për vitet 2023-2025, vijon të finanohet politika e rishikimit të masës së përfitimit të ndihmës ekonomike, në të cilën parashikohet një rritje me 10 % (dhjetë për qind) të masës së pagesës ekzistuese, sipas strukturës së familjes.

Përgjatë viteve 2023-2025, si pjesë e grupeve në nevojë do të trajtohen me ndihmë ekonomike dhe kategoritë si më poshtë:

-Gratë kryefamiljare përfitues në programin e ndihmës ekonomike, që kanë në përbërje të familjes deri në dy fëmijë të moshës 0-18 vjeç, përfitojnë dyfishin e masës së pagesës ekzistuese të ndihmës ekonomike, sipas strukturës së familjes.

-Përfituesit e programit të ndihmës ekonomike, që kanë mbushur moshën 65 vjeç, të vetmuar dhe nuk trajtohen me pension pleqërie apo pension social, përfitojnë dyfishin e masës së pagesës ekzistuese të ndihmës ekonomike.

-Anëtarët e familjeve përfituese të programit të ndihmës ekonomike që kanë mbushur 65 vjeç dhe nuk trajtohen me pension pleqërie apo pension social, përfitojnë dyfishin e masës së pagesës ekzistuese të ndihmës ekonomike, sipas strukturës së familjes.

-Masa e ndihmës ekonomike parashikohet të rritet me 10% më shumë krahasur me masën ekzistuese për famijet që trajtohen me ndihmë ekonomike, dhe nuk janë pjesë e ndonjë kategorie tjetër përfituese.

- Rezultatet që do të sjellë implementimi i reformës:

-Rritjen mbi 94% të numrit të përfituesve të varfër që marrin NE mbi totalin e aplikuesve.

-Rritjen mbi 70% të numrit të personave me aftësi të kufizuar që janë komisionuar përmes sistemit të menaxhimit të informacionit;

-Rritjen mbi 90% të numrit të përfituesve të grave kryefamiljare që marrin Ndihmë Ekonomike mbi totalin e aplikuesve gra kryefamiljare;

-Rritja me më shumë se 60 e numrit të grave dhe vajzave në nevojë të riintegruara pas trajtimit në institucionet e përkujdesit social.

SIGURIMET SHOQERORE

- Në fushën e Sigurimeve Shoqërore, për periudhën 2022-2025 synohet:
 - Garantimi i mbulimit sa më të plotë të popullsisë së vendit me elementë të sigurimeve shoqërore të detyrueshme, të mbajtura në nivele të pranueshme.
 - Vazhdimi i implementimi i reformës së pensioneve dhe përmirësimi i efikasitetit të ISSH në menaxhimin e fondeve të sigurimeve shoqërore të detyrueshme, suplementare dhe programore.
 - Përsosjes së menaxhimit të skemës së sigurimeve shoqërore, sidomos të mbledhjes së të ardhurave kontributive si dhe shpërndarjes së drejtë të tyre në formën e përfitimeve, aty dhe atëherë kur lind e drejta.
 - Vendosja e personave të siguruar dhe e përmirësimit të shërbimit ndaj tyre, në qendër të veprimtarisë së tij.Thellimi i procesit të modernizimit dhe lehtësimit të detyrës së shërbimeve Në këtë kontekst, plotësimi i kërkesave të aplikanteve jo më vonë 30 -35 ditë nga data e aplikimit.
 - Mbështetje aktive për shqiptarët që jetojnë dhe studiojnë jashtë vendit, duke i dhënë prioritet vendeve ku ka më shumë prezencë shqiptarësh.
- Rezultatet e synuara për t'u arritur në periudhën 2022-2025:
 - Rritja e nivelit të përfitimeve të pensionistëve sipas rritjes së indeksit të çmimeve të mallrave të konsumit dhe të shërbimeve, të përcaktuar në shportën e pensionistëve. Fondet kontigjencë sipas viteve janë; Viti 2023-3,580 milionë leke; Viti 2024-3,650 milionë leke; Viti 2025-3,750 milionë lekë.
 - Mbulimi i efekteve financiare të shtesës natyrale të numrit të përfituesve e cila në harkun e tre viteve parashikohet të jetë rreth 46,000 përfitues, pra një shtesë neto me rreth 15,300 persona në vit, me një efekt financiar rreth 19.8 miliardë lekë.
 - Mbulimi i efekteve financiare të skemave të reja të përfitimeve, naftëtarë minorë të cilat pas rishikimit parashikohet të sjellin një efekt financiar të harmonizuar prej rreth 1.45 miliardë lekë.
 - Sistemi do të vazhdojë të mbështesë me të ardhura mesatarisht nga 801-835 mijë persona që kanë përfituar dhe përfitojnë pensione publike, pensione suplementare si dhe një sërë të ardhurave të tjera të parashikuara me ligje si dhe, vendime të veçanta si dhe vendime kompensuese të Këshillit të Ministrave.
 - Numri mesatar i kontribuesve në skemën e sigurimeve shoqërore parashikohet mbi 789-866 mijë persona me një rritje në masën 3% në krahasim me vitin parardhës.
 - Shkalla e mbulimit të popullsisë në moshë punë (kontribues / popullsi në moshë pune) do të jetë mbi 43%.
 - Pjesa e kontributeve të sigurimeve shoqërore ndaj totalit të fondeve të alokuara për skemat e sigurimeve shoqërore do të arrijë të mbulojë mesatarisht rreth 64 % të totalit;
 - Raporti kontribues/përfitues në periudhën afatmesme ndryshon nga 1.039 për vitin 2022 në 1.015 përgjatë periudhës 2023-2025;

ARSIMI PROFESIONAL DHE PUNËSIMI

Strategjia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive 2019 - 2022 është dokumenti kryesor i politikës që udhëzon zbatimin e veprimeve që lidhen me punësimin dhe zhvillimin e aftësive në vend dhe hartohet bazuar në objektivin strategjik “Ofrimi i arsimit dhe trajnimit profesional cilësor për të rinjtë dhe të rriturit. Arsimi profesional ofrohet në 35 shkolla publike të arsimit profesional.

Këto institucione ofrojnë 25 drejtime mësimore, 86 profile profesionale dhe në total numri i nxënësve në arsimin profesional për vitin 2021-2022 është 16.599 nxënës nga të cilët 2,785 janë vajza.

- Prioritetet për periudhën afatmesme 2023-2025:

- Realizimin e nje procesi mësimor cilësor e me kushte optimale të të nxënët, teorik e praktik për t'i pajisur nxënësit me kompetencat e duhura.

- Ndërtimin, rikostruksion dhe pajisjen me pajisje dhe makineri të shkollave dhe reparteve të praktikave profesionale si një nga prioritet dhe në programin e qeverisë Shqipëria 2030 për arsimin profesional;

- Rishikimi i programeve ekzistuese dhe hartimi i programeve të reja në përputhje me parimet e barazisë gjinore dhe gjithëpërshirjes në zbatim të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve,

- Hartimi dhe miratimi i standarteve të profesioneve dhe kualifikimeve sipas niveleve të KSHK;

- Zhvillimi i vazhdueshëm profesional i mësuesve si një nga shtyllat kryesore të sigurimit të cilësisë në arsimin profesional.

- Implementimi i akreditimit të ofruesve të AFP-së;

- Funksionimi i komitetit të parë sektorial, dhe funksionimi i Këshillit kombëtar të AFP;

- Ngritja dhe funksionimi i strukturës së Inspektimit Arsimit Profesional.

- Rezultatet që synohet të arrihen për periudhën afatmesme 2023-2025:

- Rritjen e numrit të të punësuarve pas diplomimit në shkollat e mesme profesionale në 46% të totalit që mbarojnë studimet në vitin 2025;

- Rritjen e numrit të të diplomuarve në shkollat e mesme profesionale, nga 3.800 nxënës në 2021, në 4,000 nxënës në vitin 2025;

- Rritjen e numrit të nxënësve që vijnë nga zonat rurale të cilët ndjekin studimet në shkollat e mesme profesionale, nga 43% e totalit në vitin 2021 në 55% e totalit në vitin 2024; 34

- Rritjen e numrit të nxënësve me aftësi të kufizuar që ndjekin studimet në shkollat e mesme profesionale nga 154 nxënës në vitin 2022 në 160 nxënës në vitin 2025.

- Rritjen e numrit të nxënësve që ndjekin studimet në shkollat e mesme profesionale, në 19.5% të totalit të nxënësve që ndjekin arsimin parauniversitar në vitin 2025, krahasur me 18% në vitin 2022.

MBËSHËTETJA PËR RININË-AGJENCIA KOMBËTARE E RINISË

Në projekt buxhetin e vitit 2023 janë planifikuar **162, 960, 000 lekë si mbështetje për rininë**, përkatësisht në zërin 08610 të “Buxhetit 2023” sipas Ministrive të linjes dhe Institucioneve buxhetore, me një rritje krahasuar me buxhetin e vitit 2022, 161,370,000.

Më poshtë gjeni analizën e shpenzimeve korrente dhe kapitale, të ndara sipas aktivitetit:

Shpenzime korrente në shumën 112,960,000 lekë sipas kategorive në vijim:

- a) Mbështetje financiare, për veprimtarinë e Agjencisë Kombëtare të Rinisë dhe të programit kombëtar të praktikave të të rinjve.
- b) Realizimi i aktiviteteve mbi lidhësinë rinor, pjesëmarrjen në vendimmarrje, punësimin, kreativitetin dhe edukimin joformal, informimin e të rinjve, shkëmbimin e informacionit dhe pjesëmarrjen në zbatim të planit kombëtar të Veprimit për Rininë, përfshirë thirrjen e tretë për projektpropozime për rininë.
- c) Pagesë për kuotën e anëtarësimit në Organizatën Rinore të Ballkanit Perëndimor (RYCO)1 , me synim rritja e pjesëmarrjes së të rinjve në aktivitete me karakter social-kulturor dhe edukativ, rritja e pjesëmarrjes/ mbështetjes financiare të organizatave rinore në projekteve rajonale dhe të BE (RYCO, ERAZMUS +, etj).
- d) Grante për projektpropozime nga organizatat rinore dhe ose për të rinjtë në kuadër të thirrjes së tretë për projektpropozime për rininë.

BUXHETIMI I PËRGJIGJSHËM GJINOR

Për vitin 2023 Qeveria shqiptare do të vijojë të buxhetojë adresimin e çështjeve të barazive gjinore në sektorë të ndryshëm. Trendi i parashikimeve buxhetore lidhur me sektorët që adresojnë çështje të barazive gjinore vijon të jetë i njëjtë me vitet paraardhëse, ku rreth 9% e shpenzimeve të përgjithshme për të gjithë sektorët në nivel qendror parashikohet të shkojë për realizimin e objektivave gjinorë në: arsim, shëndetësi, mbrojtje sociale, rend publik, bujqësi, drejtësi, etj. Më konkretisht, më poshtë disa të dhëna për sektorët:

Në sektorin e shëndetësisë do të vijojnë të mbështeten nënat e reja me shërbime të shëndetit parësor. Do të shtohet numri i grave dhe vajzave që përfitojnë nga shërbimet e depistimit të kancerit të gjirit dhe qafës së mitrës, do të punohet për të shtuar numrin e burrave të moshës 35-66 vjeç që përdorin shërbimet e check-up për identifikimin në kohë të sëmundjeve, etj.

Në fushën e mbrojtjes sociale do të rritet financimi i politikës së rishikimit të masës së përfitimit për Ndhimën Ekonomike si dhe politika e mbështetjes së çmimit të energjisë për përfituesit e kategorisë PAK, ku rreth 44% të përfituesve janë gra. Gjithashtu do të mbështetet edhe financimi i skemës së mbështetjes së nënave me 3 (tre) apo më shumë fëmijë të mitur me kosto rreth 600 mln lekë.

Politikat e punësimit dhe të arsimit profesional për gratë dhe vajzat vijojnë të jenë prioritet për këtë ministri, ashtu sikurse edhe politikat e mbrojtjes sociale të strehimit social apo të sigurimeve shoqërore, te cilat synojnë jo vetëm fuqizimin e grave dhe vajzave, por edhe ndihmën specifike ndaj atyre që janë viktimë të dhunës më bzaë gjinore apo në familje.

Rreth 9,787,459,644 lekë planifikohet të shpenzohen për këto politika gjatë 2023.

IV. Çështje të diskutuara, lidhur me projektbuxhetin në komision

Gjatë prezantimit të projektbuxhetit në Komision, Ministrja e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale znj. Ogerta Manastirlliu informoi deputetët se projektbuxheti 2023 mbështetet në shtyllat e programit qeverisës për shëndetësinë dhe mbrojtjen sociale, duke synuar mbulim shëndetësor universal, shërbime cilësore, mbrojtjen e shëndetit publik përmes vaksinimit antiCovid të popullatës dhe konsolidimin dhe rritjen e mburojës sociale për kategoritë në nevojë.

Buxheti i shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale për vitin 2023 parashikohet 95,122,728 mijë lekë, është parashikuar me një rritje prej 3.5 % krahasuar me buxhetin aktual të vitit 2022. 64,496 miliard lekë janë të dedikuar për sektorin e shëndetësisë. 30,628 miliard lekë për programet e mbrojtjes sociale

Gjithashtu, Ministrja e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale shtoi, se, buxheti total i MSHMS duke përfshirë kontributet shëndetësore i krahasuar kundrejt PPB për vitin 2023 është 4.37% e PBB. Buxheti total i MSHMS duke përfshirë kontributet është rreth 14 % e Buxhetit të shtetit.

Për tre vitet 2023-2025 projeksionet e kontributeve shëndetësore janë si më poshtë:

Për vitin 2023 (17,077,000 mijë lekë) është parashikuar me një rritje prej 7.1 % krahasuar me 2022.

Për vitin 2024, (16,875,000 mijë lekë)

Për vitin 2025 (17,955,000 mijë lekë)

Zv. Ministrja e Financave dhe Ekonomisë, znj. Olta Manjani informoi deputetët se misioni i sistemit të sigurimeve shoqërore dhe ISSH-së është zbatimi i objektivave të qeverisë në fushën e sigurimit social, në vecanti në fushën e pensioneve, si dhe administrimin i sigurimeve shoqërore dhe zbatimin e buxhetit vjetor të miratuar për këtë sistem.

Sistemi i Sigurimeve Shoqërore realizon objektivat e saj nepermjet menaxhimit me eficencë i tre programeve bazë: “Sigurimi Shoqëror i Detyrueshëm”, “Sigurimi Suplementar”, si edhe “Programet Kompensuese të Shtetit dhe Trajtimet e Veçanta”.

Gjatë vitit 2022, si dhe për periudhën afatmesme 2023-2025 është parashikuar të ketë një ecure normale të kryerjes së pagesave për përfituesit e skemës së sigurimeve shoqërore.

Shpenzimet e sigurimeve shoqërore në variantin pasiv për vitin 2023 parashikohen të rriten kundrejt PBB, mesatarisht me 7.68% nga 7.6 % që priten të jenë për vitin 2022.

Për vitin 2022, si vit bazë për parashikimet e mëtejshme, shpenzimet priten në shumën 156.9 miliardë lekë, në vitin 2023 në variantin pasiv këto shpenzime parashikohen të arrijnë në shumën 162.5 miliardë lekë.

Në variantin aktiv shpenzimet për vitin 2023 janë parashikuar në masën 167.3 miliardë lekë ku kontigjenca për bonusin dhe indeksimin e pensioneve është parashikuar në masën 4.730 miliardë. Pra kemi një rritje të shpenzimeve për vitin 2023 kundrejt vitit 2022 me rreth 10 miliardë leke. Programi Sigurimi i detyrueshëm shoqëror për vitin 2023 zë rreth 87% të totalit të transfertave në buxhetet familjare.

Programi Sigurime suplementare për vitin 2023 zë 4.7% të shpenzimeve të sigurimeve shoqërore, dhe financohet kryesisht nga Buxheti i Shtetit dhe nga kontributet suplementare.

Përsa i përket Programeve aktive të Tregut të Punës, Ministria e Financave dhe Ekonomisë po harton Strategjinë e re e cila do të mbulojë periudhën 2023-2030. Vizioni i strategjisë së re është “Punësim cilësor dhe aftësim i vijueshëm për të gjithë” dhe ka si qëllim (i) zhvillimin e aftësive dhe lidhje më të mirë e kërkesës me ofertën në tregun e punës për punësim më të lartë; (ii) mundësimi i punësimit të denjë nëpërmjet zbatimit të politikave gjithëpërfshirëse të tregut të punës. Në zbatim të ligjit 15/2019 janë miratuar dhe vënë në zbatim 8 programe të reja të Nxitjes së Punësimit, duke përfshirë ato për situatën COVID-19, për të arritur një përgjigje më të mirë ndaj nevojave të punëkërkuarëve të papunë, veçanërisht atyre më të cenueshëm dhe për të harmonizuar ndërveprimet dhe ndërhyrjet e Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive, Shërbimit Social Shtetëror dhe autoriteteve lokale.

Ministrja e Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, znj. Bora Muzhaqi, pasi bëri shpjegimin dhe ndarjen e buxhetit sipas zërave, tha në fjalën e saj, se nga thirrja e parë për rininë janë financuar 12 projekte të organiztave rinore/për të rinjtë dhe 4 projekte të infrastrukturës rinore në 4 bashki në vlerën totale 48 milionë lekë (buxheti 2021). Nga thirrja e dytë për rininë pritet të financohen mbi 20 projekt propozime rinore të organiztave rinore/për të rinjtë dhe 5 projekte të infrastrukturës rinore në 5 bashki në vlerën totale 108 milionë lekë (buxheti 2022) dhe do të vijohet në po të njejtat linja edhe për vitin 2023.

Nga Ministrja e Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, u theksuan dhe qëllimet politike, si:

-Të rehat dhe të rinjtë marrin pjesë aktivisht në shoqëri dhe ndihen të fuqizuar për t'u shprehur me zërin e tyre. Politikat ndërsektoriale rinore janë të koordinuara, të bazuara në analiza, me mekanizma të mirë financiar.

-Mbështetet dhe nxitet novacioni rinor dhe rritja e aftësive dhe profesionalizmit të të rejave dhe të rinjve përmes edukimit cilësor në TIK dhe fusha të tjera të zhvillimit digjital duke rritur dhe përmirësuar kështu mundësitë për të hyrë në tregun e punës;

-Mirëqenia aktive, e shëndetshme, fizike, sociale dhe mendore e të rinjve. Siguria, mbrojtja dhe përfshirja e të rinjve në të gjithë diversitetin e tyre, veçanërisht për ata të rinj që janë në situatë rreziku apo mënjanimi social (vulnerabiliteti).

Relatoret e maxhorancës të projektligjit për buxhetin: znj. Dasantila Tahiri dhe znj. Mirela Pitushi, vlerësuan mbështetjen buxhetore për Shëndetësinë, mbrojtjen sociale, arsimin profesional, rininë dhe fëmijët, të cilat do kenë një impakt të ndjeshëm te qytetarët gjatë vitit të ardhshëm. Znj. Tahiri, theksoi se buxheti i shëndetësisë është buxheti më i lartë në vitet e fundit. Me rritjen e këtij buxheti është bërë një hap cilësor drejt angazhimit për investime dhe për rritjen e vëmendjes ndaj shpenzimeve në këtë fushë të rëndësishme.

Znj Mirela Pitushi vlerësoi menaxhimin që iu bë dy fatkeqësive natyrore si tërmetit ashtu edhe pandemisë së shkaktuar nga COVID-19. Ajo vlerësoi shpenzimet për Ndihmën Ekonomike dhe Pagesën e Paaftësisë (PAK), mbështetjen e madhe financiare që iu është bërë shtresave në nevojë në drejtime të ndryshme, si dhe shpenzimet për bonusin e lindjeve.

Relatoret e opozitës të projektligjit për buxhetin, zonja Zheni Gjergji, në fjalën e saj theksoi problematikat e këtij buxheti në fushën e shëndetësisë, si: Vizitat mjekësore shërbimi parësor, Receta të rimbursuara nga mjeku i familjes, Rikonstruksion me kredi, Investime qëndra shëndetësore, vaksinimi anti-covid19. Vlera për këtë zë është reduktuar nga 2.46 miliardë lekë në 1.55 miliardë lekë edhe pse cmimi për njësi është rritur me afro 9% në 1,335 lekë. Fondi për depistimin e kancerit të gjitit, qafës së mitrës mbetet i njëjtë, ndërsa shtimi rasteve për të dyja kategoritë rritet me mbi 10% cdo vit. Është e paqartë se si Ministria pretendon të ulë këto kosto, apo kjo do të sjellë dhe një cilësi shërbimi më të ulët.

Më tej, zonja Gjergji, theksoi se ka një ulje neto të kostos për numër vizite. Pse kjo ulje për këtë zë të buxhetit? Ndaj edhe nëse ky shpenzim i parashikuar mund të konsiderohet si një ardhur e cila mund të vijë nga supozimi hipotetik nga efektet e mundshme të reformës së autonomisë spitalore apo ndonjë reforme tjetër që parashikon qeveria pasi në këtë rast kemi të bëjmë jo me shërbimin dytësor por atë parësor mbetet plotësisht e paqartë. Kjo pasi nuk mund të pretendohet se do të gjenerohen ajo shumë të ardhurash nga burime jashtë buxhetore që me fjalë të thjeshta do të jenë prej xhepave të qytetarëve që do duhet të paguajnë ndoshta para ekstra për konsulta të tjera pranë shërbimit parësor, pra si e ardhur që mund të gjenerohet nga “praktikat e dyfishta” që me sa duhet hipotetizohet qeveria e parashikon ta shtrijë jo vetëm në sistemin dytësor por dhe atë parësor përderisa ka bërë dhe këtë parashikim në kufinj të absurdit jo vetëm prej shifrës por dhe të aplikimit në këtë shërbim shëndetësor.

Ilda Dhori, vlerësoi rritjen e buxhetit, por problematika në buxhetet e këtyre viteve ka qenë vendosja e prioriteteve. Ajo theksoi, se ndihma ekonomike, duke iu referuar shifrave më të fundit të Bankës Botërore se deri në fund të vitit 2022 më shumë se 35 mijë familje shqiptare më shumë do ti shtohen nën të ardhurat e konsideruar varfëri ekstreme. Po ashtu dhe sa i përket mbështetjes për familjet e personave PAK dhe kujdestarisë viti 2023 do të shënoi një rënie në 7 mijë nga 167 mijë në 160 mijë. Vlera totale e mbështetje do të pësoi po ashtu një reduktim prej 400 milion ose 3.4 milion euro më pak mbështetje. Përkujdesi në qendrat rezidenciale, ka si problematikë reduktimin më të madh që do i përkasi përfutuesve të shërbimeve të përkujdesit të ofruara në qendrat rezidenciale publike ku për vitin 2023 do të jenë vetëm 180 nga 450 që ishin në 2022 ose 2.5 herë më pak. Për vitin 2023 do të ketë 3 herë më pak persona të pafavorizuar të punësuar në ndërmarrje sociale.

Për sa i përket Skemës së Sigurimeve Shoqërore, zonja Dhori, relatores e projektligjit, u shpreh, se Ministria parashikon për vitin 2023, ndërkohë për 2022 nuk ka qënë e aplikuar alokimin e një fondi prej 296,076,932 lekë për 350 Inspektorë që kryejnë mbledhjen dhe administrimin e kontributeve të fermerëve dhe kontributeve vullnetare. Burimi I këtij fondi është “jashtë buxhetor”. Është e paqartë se përse këtë vit parashikohet kjo vlerë prej 300 milionë lekësh për “mbështetje” të inspektorëve? Pra bëhet fjalë për hapjen e vendeve të reja të punës për inspektorë të rinj pra 350 apo është një bonus për inspektorë ekzistues? Nëse mbledhja dhe adminstrimi bëhet nga inspektorë ekzistues pse në vitet e mëparshme nuk ka patur një fond të dedikuar? Nëse është fond për pagat pse nuk është përlloritur dhe vlera e sigurimeve? Dhe nëse është bonus pse nuk është përlloritur tatimi mbi të ardhurat?

Znj. Grida Duma, Kryetare e këtij Komisioni, në fjalën e saj tha se për sa i përket skemës së ndihmës ekonomike, është një skemë, e cila ka nxjerrë jashtë saj një numër të konsiderueshëm familjesh në nevojë. Ne kemi kërkuar dhe kërkojmë transparencën për përjashtimin e këtyre familjeve dhe përtej kësaj akoma nuk kemi arritur në diskutime për minimumin jetik në të cilin jeton sot një familje shqiptare. Nuk dimë ende nëse kjo ndihmë ekonomike u jep mundësi familjeve në nevojë për të mbijetuar.

Ndihma Ekonomike reduktohet numri i familjeve përfituese nga 67 mijë familje në 64 mijë familje pra 3 mijë më pak, poashtu vlera e fondit reduktohet me mbi 400 milion lekë. Ndërkohë referuar raportit UNICEF efekti i rritjes së cmimeve ka krijuar mbi 40 mijë familje në varfëri ekstreme në Shqipëri deri në Shtator të 2022.

Për vitin 2022 sipas UNICEF 12 mijë fëmijë më shumë kanë hyrë nën minimumin jetik të varfërisë për shkak të mungesës së politikave të duhura sociale dhe ekonomike të cilat mund të zbusnin efektet e krizes së krijuar nga rritja e cmimeve. Mbi 40 mijë shqiptarë të tjerë kanë hyrë po ashtu në varfëri sipas të njëjtit raport.

Shqipëria ka nivelin e varfërisë (5.5 USD per capita per day) më të lartë në rajon dhe gati dyfish të mesatares rajonale. Mbi 4 herë më të lartë se sa mesatarja e vendeve të BE.

Shpenzimet në buxhetin e shtetit për vitin 2023 për Ndihma ekonomike dhe Aftësia e Kufizuar kanë pësuar një rënie në raport me PBB në nivelin 1.2% krahasuar me nivelin 1.5% në vitin 2020; Pensionet për PAK reduktojnë me 7 mijë përfituesit por dhe pagesat me 400 milion lekë më pak ose 3.4 milion euro më pak.

Mbështetja Sociale do të pësoi një reduktim të buxhetimit prej 1.1 miliardë lekë ose gati 10 milion euro më pak në vitin 2023 krahasuar me vitin 2022. Po ashtu dhe sa i përket mbështetjes për familjet e personave PAK dhe kujdestarisë viti 2023, do të shënojë një rënie në 7 mijë nga 167 mijë në 160 mijë. Vlëra totale e mbështetje do të pësojë, po ashtu, një reduktim prej 400 milion ose 3.4 milion euro më pak mbështetje.

Buxheti i planifikuar për rininë është një buxhet i padetajuar.

Referuar shqetësimit të ngritur dhe në progres raportin e Komisionit European ku evidenton se kequshqyerja tek fëmijët në Shqipëri është një shqetsim thelbësor, a ka draftuar Ministria një program me shkollat për ndërgjegjshimin dhe zbutjen e këtij fenomeni për të promovuar mirëushqyerjen, duke qënë se është dhe rekomandim i Komisionit European?

Po ashtu kequshqyerja tek fëmijët është vërtetë në shifra alarmante, ku gjatë 8 viteve të fundit është në raportin 1 në 5 fëmijë, shumë herë më e lartë se mesatarja e vendeve të rajonit 1 në 14 fëmijë.

Kryetarja e komisionit, gatë diskutimit të saj, drejtoi pyetje për Këshillin e Ministrave, si:

A ka dijeni Ministria se sipas raportit më të fundit të UNICEF mbi 12 mijë fëmijë shqiptarë kanë hyrë nën minimumin jetik për vitin 2022 me një rrezikshmëri latente kequshqyerje si pasojë e krizës së cmimeve, shifër kjo disa herë më e lartë se gjithë vendet e rajonit me përjashtim të Kosovës, jo vetëm për vlerë nominale por dhe në raport me popullsinë?

Sa është raporti i tyre, për fëmijë për psikologë dhe punonjës socialë respektivisht sidomos për fëmijët me aftësi ndryshe?

Cfarë hapash konkretë propozon Ministria juaj për të promovuar edhe më tej punësimin dhe integrimin e të rinjve PAK në tregun e punës?

Në vazhdim të diskutimit në Komision, të ftuarit në komision, konkretisht, ministret përkatëse iu përgjigjën pyetjeve të deputetëve lidhur me parashikimet e buxhetit për shëndetësinë, mbrojtjen sociale, arsimin profesional, punën, rininë dhe fëmijët.

Kryetarja e Komisionit, në fund të diskutimeve të deputetëve dhe të ftuarve, shpjegoi votën kundër buxhetit 2023, si një buxhet që nuk akomodon asnjë problematikë të evidentuar nga raportet e fundit të Bankës Botërore, Eurostat, Komisionit European apo KLSH.

Projektligji për buxhetin 2023 në tërësi është një projektligj jashtë nevojave reale të qytetarëve dhe kryesisht i orientuar në shpenzime të lidhura dhe me fushat elektrorale të qeverisjes vendore.

Po ashtu nisur nga parashikimi për vitin 2023 dukshëm në fushat relevante të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale vihet re se qeveria jo vetëm që nuk do të ofrojë një mbështetje për kategoritë sociale të shoqërisë që e ndejnë më shumë krizën e ekonomike, rënien e konsumit të gjeneruar nga rritja e cmimeve të konsumit në tërësi, pasiguria energjitike por dhe mungesa e politikave të drejtëpërdrejta sociale për këto kategori.

Qeveria nuk ka parashikuar një indeksim real të pensioneve, ndërkohë për vitin 2023 parashikon edhe fondin shtesë pra bonusi i fundvitit të ardhshëm të reduktohet në vlerën 1.25% nga 4.09 miliardë këtë vit në 4.04 miliardë në 2023. Ndërkohë sipas qeverisë norma e inflacionit nuk do jetë më e vogël se 4% dhe nga ku rritja e cmimeve të produkteve bazë ushqimore sipas Bankës Kombëtare nuk pritet të ndalet as në vitin 2023.

Nga ana tjetër qeveria nuk po e njeh realitetin e varfërisë në Shqipëri ku sipas të dhënave të Bankës Botërore në vitin 2021 ai ishte rreth 35% gati dy fish më e lartë se mesatarja e rajonit dhe 4 herë më e lartë se mesatarja e vendeve të BE. Ndërkohë vetëm për vitin 2022 sipas raportit të UNICEF kriza e cmimeve ka shkatuar varfërimin dhe vendosjes së 12 mijë fëmijë shqiptarë në kushte të varfërisë ekstreme dhe së paku mbi 40 mijë personave janë regjistruar të rinj nën minimumin jetik ndërkombëtar.

V. Përfundimi

Pas përfundimit të diskutimeve të zhvilluara nga anëtarët e Komisionit, Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë, me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm, miratoi në parim projektligjin “Për buxhetin e vitit 2022”, duke konstatuar se:

- Në aspektin ligjor projektligji është në përputhje me nenet 158 dhe 159 të Kushtetutës;
- Në aspektin procedural, projektligji është paraqitur dhe po shqyrtohet në përputhje me Rregulloren e Kuvendit.

Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë, në përputhje me afatet e përcaktuara Kalendarin e Kuvendit sipas nenit 79 të Rregullores për shqyrtimin e projektligjit të Buxhetit të Shtetit të Vitit 2023 dhe bazuar në nenin 80 të Rregullores së Kuvendit, ia paraqet këtë raport Komisionit për Ekonominë dhe Financat.

RELATORË

**Mirela Pitushi,
Desantila Tahiraj
Zheni Gjergji
Ilda Dhori**

**KRYETARE
Grida DUMA**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

KOMISIONI PËR PUNËN, ÇËSHTJET SOCIALE DHE SHËNDETËSINË

Tiranë, më 02.11.2022
Dokument parlamentar
(Komision për dhënie mendimi)

**RAPORT
PËR PROJEKTLIGJIN “PËR BUXHETIN E VITIT 2023”
NEN PËR NEN**

Drejtuar: Komisionit përgjegjës për Ekonominë dhe Financat
Seancës Plenare

Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë, bazuar në Kalendarin e posaçëm të Kuvendit për shqyrtimin e projektligjit “Për buxhetin e vitit 2023”, në mbledhjet e tij të datës 8 dhe 14 nëntor, shqyrtoi projektligjin “Për buxhetin e vitit 2023”, nen për nen.

Të ftuar për të marrë pjesë në diskutim dhe për t’iu përgjigjur pyetjeve të deputetëve ishin përfaqësues të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe Ministrisë së Shtetit për Rininë dhe Fëmijët.

Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë e shqyrtoi këtë projektligj në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi, bazuar nën 32-39 dhe nën 80 të Rregullores së Kuvendit.

Gjatë shqyrtimit të projektligjit nen për nen, Ministrinë përkatëse nuk shprehën kërkesa për shtesa në programet e tyre buxhetore.

Komisioni, bazuar në nenin 36 dhe 80 të Rregullores, u konsultua dhe mori sugjerime/opinione me shkrim me përfaqësues të ministrive të linjës, Avokatin e Popullit dhe me përfaqësues të organizatave jofitimprurëse që veprojnë në mbrojtje të të drejtave të fëmijëve, organizatave të personave me aftësi të kufizuar, organizatat e romëve dhe egjiptianëve, sindikatat e pavarura dhe konfederata, etj.

Pasi diskutoi mbi propozimet e bëra nga grupet e interesit, pasi dëgjoi mendimin e përfaqësuesve të Ministrive përkatëse si dhe pas diskutimeve të anëtarëve të tij, Komisioni ra dakord, që me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm, të miratojë nen për nen dhe në tërësi projektligjin.

**Kryetare
Klodiana SPAHIU.**